



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 41

Datë 1 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8517 datë 13.3.2014	Për emërim gjyqtari	1013
Dekret nr. 8518 datë 13.3.2014	Për emërim gjyqtari	1013
Vendim i KM nr. 144, datë 12.3.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar	1013
Vendim i KM nr. 152, datë 19.3.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga rehabilitimi dhe zgjerimi i varrezave publike, Sharrë, faza IV, dhe Tufinë, fazat III dhe IV, në bashkinë e Tiranës	1013
Vendim i KM nr. 153, datë 19.3.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i shëtitores në Orikum, faza II, të bashkisë Orikum	1016
Vendim i KM nr. 154, datë 19.3.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 144, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e një ekipi këshillues ushtarak (MAT-a) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin ushtarak “ISAF”, në Afganistan”	1016
Vendim i KM nr. 156, datë 19.3.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 804, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar	1017

Udhëzim i MMSR nr. 2, datë 10.3.2014	Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të përkujdesit shoqëror	1017
Udhëzim i MMSR nr. 3, datë 10.3.2014	Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar....	1018
Udhëzim i MMSR nr. 4, datë 11.3.2014	Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike	1021
Udhëzim i MZHETS nr. 217, datë 28.3.2014	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore që miratohen në këshillin kombëtar të territorit, si dhe për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e tyre	1022
Kërkesë e MEI nr. 887/2, datë 19.3.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të tipit “tokë bujqësore arë”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv, Ersekë-Përmet”	1025
Kërkesë e MTI nr. 1492, datë 17.3.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim rrugët paralele superstrada Tiranë-Vorë, krahu i majtë (vazhdimi)”	1030
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Gëzim Hajdari	1030

DEKRET
Nr. 8517, datë 13.3.2014
PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Olsi Xhavella, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr.8518, datë 13.3.2014
PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Enton Dhimitri, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 144, datë 12.3.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 35, DATË 29.1.2014 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOQSHME PËR VITIN 2014
NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të

nenit 11 të ligjit nr. 185, datë 28.12. 2012 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Përrjashtimisht për punonjësit e kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët merren me anketimet, miratimi i numrit të tyre, përcaktimi i afateve kohore dhe specifikime të tjera bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Financave.”.

b) Fjalja e dytë e pikës 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përrjashtimisht për QTTB-të, për punonjësit e SHISH-it (shtëpitë e pushimit) dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të institucioneve për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 152, datë 19.3.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA
REHABILITIMI DHE ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, SHARRË, FAZA IV, DHE TUFINË,
FAZAT III DHE IV, NË BASHKINË E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga rehabilitimi dhe zgjerimi i varrezave publike, Sharrë, faza IV, dhe Tufinë, fazat III dhe IV, në bashkinë e Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Tiranës.

3. Për rehabilitimin dhe zgjerimin e varrezave publike, pronarët kompensohen sipas vlerave të përcaktuara në tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi, si më poshtë vijon:

a) Sharrë, faza IV, për sipërfaqen 10 604 (dhjetë mijë e gjashtëqind e katër) m² truall, 4 851 798 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

b) Tufinë, faza III, për sipërfaqen 5 729 (pesë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) m², truall, 2 236 416 (dy milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

c) Tufinë, faza IV, për sipërfaqen 15 688 (peshmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) m², truall, 5 187 840 (pesë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet) lekë.

Vlerat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike, të përballohen nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës, miratuar në buxhetin e vitit 2014.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Tiranës.

5. Afati i përfundimit të projektit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

6. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 10 604 m², truall, Sharrë, faza IV, 5 729 m², truall, Tufinë, faza III, si dhe 15 688 m², truall, Tufinë, faza IV, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit “Rehabilitimi dhe zgjerimi i varrezave publike, Sharrë, faza IV, dhe Tufinë, fazat III dhe IV”, në bashkinë e Tiranës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
“PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, TUFINË, FAZA E TRETË”
Zona kadastrale 3426

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe e përgjithshme/m ²	Sipërfaqe e prekur/m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Qemal Shaban Shtishi	2629	1600	830	448	371.840	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
2	Shtet	2630	800	530	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
3	Hajdar Shtishi	2617	1700	1700	448	761.600	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
4	Shtet	2623	330	207	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
5	Muharrem Shaban Shtishi	2621	2000	1585	448	701.200	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
6	Dragut Bilal Kuka	2628	6380	53	448	23.744	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
7	Kadri Çakmashi	2613	5430	844	448	378.112	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011

5729 m²	Shuma	2.236.416 lekë
---------------------------	--------------	-----------------------

TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
“PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, TUFINË, FAZA E KATËRT”

Zona kadastrale 3426

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe e përgjithshme /m ²	Sipërf. e prekur/m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Muharrem Shaban Shtishi	26/21	2000	435	448	194880	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
2	Dragut Bilal Kuka	26/28	6380	6327	448	2834496	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
3	Shtet	26/27	220	220	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
4	Xhelal Shima	26/14	5000	2000	448	896000	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 09.12.2011
5	Shtet	26/35	466	405	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
6	Resmi Shefqet Kuka	26/34	2220	2270	448	1016960	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
7	Shtet	26/23	330	123	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
8	Shtet	26/25	2770	2770	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
9	Qefalie, Lulzim Daja	26/8	1940	265	448	118720	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
10	Kadri Çakmashi	26/13	5430	283	448	126784	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
11	Shtet	615	700	590	448	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 10959/1, datë 9.12.2011
				15688 m²	SHUMA	5.187.840 lekë	

TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
“PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, SHARRË FAZA E KATËRT”

Zona kadastrale 3321

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe e përgjithshme/m ²	Sipërfaqe e prekur/m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Varreza në pronësi të shtetit	142	6000	910	662	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
2	Rrugë në pronësi të shtetit	372	200	200	662	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
3	Kanal në pronësi të shtetit	362	26.900	1122	662	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
4	Rrugë në pronësi të shtetit	373	1200	628	662	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
5	Bashkëpronarët Muça	143/3	6200	6.200	662	4.104.400	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
6	Bashkëpronarët Muça	143/2	6100	992	662	656.704	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
7	Shtet	143/6	2830	415	662	0	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013
8	Selman Hamit Muça	127/4	4000	137	662	90.694	Konfirmuar nga ZVRPP, nr. 5837/1, datë 13.3.2013

10.604 m²	Shuma	4.851.798 lekë
-----------------------------	--------------	-----------------------

VENDIM

Nr. 153, datë 19.3.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMI I
SHËTITORES NË ORIKUM, FAZA II, TË
BASHKISË ORIKUM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i shëtitores në Orikum, faza II, në bashkinë Orikum, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë Orikum.

3. Vlera e shpërblimit, për sipërfaqen 65.2 (gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m², truall, në masën 7 781 000 (shtatë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Orikumit, miratuar në buxhetin e vitit 2014.

4. Afati i përfundimit të shpronësimin të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Orikumit.

6. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 65.2 (gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m² truall, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit "Ndërtimi i shëtitores në Orikum, faza II", në bashkinë Orikum, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Orikumit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
PËR "NDËRTIMI I SHËTITORES ORIKUM, FAZA E II- TË"**

Emër, mbiemër	Sip në m ²	Çmimi/lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Zona kadastrale
Përparim Kulluri	65.2 m ²	119 340	7 781 000	Vërtetim pronësie	2832

VENDIM

Nr. 154, datë 19.3.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 144,
DATË 20.2.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
"PËR PJESËMARRJEN E NJË EKIPI
KËSHILLUES USHTARAK (MAT-A) TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, NË OPERACIONIN USHTARAK
"ISAF", NË AFGANISTAN"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 144, datë 20.2.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Misioni i ekipit këshillues ushtarak (MAT-A) është të asistojë dhe të këshillojë për trajnimin, drejtimin, mbështetjen dhe zhvillimin operacional të Forcave të Lëvizshme Dislokuese të Brigadës së Parë Afgane (Br1Mobil Strike Force), duke vepruar e kryer detyra operationale e luftarake në zonën e përgjegjësisë së Komandës Rajonale-Qendrore (RC-C), operacioni "ISAF", në Kabul, Afganistan, me qëllim zhvillimin e një force të aftë, kompetente dhe profesionale."

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për çdo vit në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM**Nr. 156, datë 19.3.2014****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 804, DATË 21.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRVE "PËR MIRATIMIN E REGULLORES SË PERSONELIT TË POLICISË SË SHTETIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 41, 49, 52, 86 dhe 129, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit" të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nenin 26 të rregullores së personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

"6. Ministri i Punëve të Brendshme, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pranon në polici aplikantë nga radhët e fëmijëve të punonjësve të policisë, të cilët kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës.

7. Aplikanti pranohet në polici pasi të ketë plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 6, të ketë paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në nenin 7 dhe t'i jetë nënshtruar procedurës së testimit sipas shkronjave "c", "ç", "d", "dh" dhe "e" të nenit 13 të kësaj rregulloreje.

2. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM**Nr. 2, datë 10.3.2014****PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 18, pika 1 dhe 27, pika 6, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 5, kreu II dhe pikës 4, kreu XI, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kërkesat e subjekteve fizike/juridike, ofruese të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që kanë aplikuar pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Licencimeve (QKL) për t'u pajisur me licencë për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe janë miratuar në fazën e parë, kalojnë në mënyrë elektronike pranë Drejtorisë së Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara, pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

2. Personi përgjegjës pranë kësaj drejtorie, bën regjistrimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të ardhur në regjistrin elektronik të krijuar për këtë qëllim dhe e përcjell atë në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore menjëherë.

3. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i cili përfshin dokumentet provuese sipas aneksit 1, fusha X kategoria X. 1. B, bashkëngjitur vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta" të Këshillit të Ministrave;

b) shqyrton dokumentet provuese për drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës "a", pika 2, kreu III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, si: diplomën universitare në degët mjekësi, ekonomi dhe shkenca sociale, apo diploma masteri të nivelit të dytë në këto degë;

c) bën inspektimin në vend të shërbimit që ofron subjekti. Inspektimi në vend përfshin kontrollin e cilësisë së shërbimeve nëse subjekti ofron shërbim, plotësimin e standardeve sipas natyrës së shërbimeve, kriterëve përkatëse të licencimit sipas kategorisë X. 1, III. 7 të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

4. Në rast se gjatë inspektimit vihen re shkelje, pasaktësi të dokumentacionit, mosplotësim i standardeve apo mospërputhje me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore i kërkon subjektit plotësimin e mangësive të konstatuara, brenda 2 ditëve pune. Nëse këto mangësi nuk plotësohen brenda këtij afati, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore i propozon Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Licencim pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të mos miratojë kërkesën e subjektit për t'u pajisur me licencë.

5. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe kryerjes së inspektimit në vend, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dërgon në Drejtorinë e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara, pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, brenda 5 ditëve pune nga momenti i marrjes së dokumentacionit nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:

a) dokumentacionin që ka paraqitur aplikuesi;
b) vlerësimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe të Shërbimeve Shoqërore.

6. Drejtoria e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara informon me shkrim kryetarin e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licenca, duke i propozuar datën për mbledhjen e komisionit. Kryetari i Komisionit vendos për datën e mbledhjes së komisionit.

7. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencim kryesohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe përbëhet nga 4 anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Sociale;
b) Drejtoria e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara;
c) Drejtoria e Shërbimeve Juridike;
ç) Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Ngritja e komisionit dhe caktimi i anëtarëve të tij bëhet me urdhër të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

8. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencim, pasi bën vlerësimin e dokumentacionit, vendos:

a) miratimin e kërkesës për pajisje me licencë;
b) refuzimin e kërkesës për pajisje me licencë.

9. Në rast se kërkesa miratohet, vendimi miratues, së bashku me arsyetimin ligjor përkatës përcillet në Qendrën Kombëtare të Licencimit, e cila pajis me licencë subjektin ofrues të shërbimeve të përkujdesit rezidencial me kodin X. 1. B.

10. Në rast se kërkesa refuzohet, komisioni harton me shkrim arsyetimin ligjor përkatës, në të cilin përcaktohen qartë shkaqet e refuzimit, dhe ia dërgon Qendrës Kombëtare të Licencimit.

11. Nëse subjekti nuk është dakord me vendimin e marrë nga komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencë, për refuzimin e kërkesës për licencim, ai ka të drejtën e ndjekjes së procedurës së ankimimit sipas nenit 30 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit për refuzimin e kërkesës.

12. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shqyrton ankimimin dhe merr vendim brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të tij. Në rast se ky afat tejkalohet, si dhe në rastet kur ministri lë në fuqi vendimin për mosmiratimin e kërkesës për licencë,

subjekti fizik/juridik i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të shqyrtimit të ankimimit.

13. Për pajisjen me licencë për veprimtari të përkujdesit shoqëror, përveç tarifës së Qendrës Kombëtare të Licencimit, subjekti detyrohet të paguajë tarifën prej 10.000 lekë pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e cila derdhet në llogarinë bankare të këtij institucioni. Një kopje e faturës paraqitet pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Licencimit, në çastin e marrjes së licencës. Këto të ardhura përdoren nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë sipas legjislacionit në fuqi.

14. Pas licencimit nga Qendra Kombëtare e Licencimit, subjektet e licencuara i nënshtrohen një kontrolli periodik, jo më pak se dy herë në vit, i cili kryhet nga struktura përkatëse e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe/ose rajonal, sipas planit të punës të miratuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

15. Nëse gjatë kontrollit të subjekteve të licencuara konstatohet se janë paraqitur deklarime të rreme, nuk janë respektuar standardet e kërkuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, ose veprimtaria kryhet jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i propozon komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencim të vendosë lidhur me revokimin e licencës. Bazuar në vendimin e komisionit, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë kërkon nga QKL-ja revokimin e licencës.

16. Udhëzimi nr. 1456, datë 28.7.2009 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të përkujdesit shoqëror”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erjon Veliaj

UDHËZIM
Nr. 3, datë 10.3.2014

**PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE TË PAGESAVE
PËR AFTËSINË E KUFIZUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 185/2013, datë 30.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të

Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe pikës 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit, dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si edhe të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 3, datë 17.1.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”,

UDHËZOJ:

1. Administratori shoqëror në bashki/komunë, në përputhje me kriteret dhe treguesit, programon kërkesat për fonde për pagesat për personat me aftësi të kufizuara dhe i dërgon në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Programimi i fondeve për pagesat e personave me aftësi të kufizuar bëhet për çdo grup në veçanti, në përputhje me nenet 7 dhe 8 ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, të ndryshuar, për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, për personat me aftësi të kufizuar fizike e mendore, si edhe për invalidët e punës. Programi i fondeve për të verbrit bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 1956, datë 19.9.2006.

3. Fondet e nevojshme për të gjitha grupet e PAK të bashkisë/komunës përlllogariten në bazë të numrit të personave me aftësi të kufizuara për secilin grup të vlerësuar sipas vendimit të KMCAP/KMPV dhe masës së përfitimeve për secilën kategori.

Për të gjitha kategoritë mbahen parasysh pagesat e diferencuara që përfitojnë individë të veçantë për periudhën kur ndjekin arsimin e mesëm, të lartë apo pasuniversitar, pagesave për kompensimin financiar për energjinë elektrike, telefoninë fikse apo edhe pagesën për paketën higjieno-sanitare. Të dhënat e mësipërme plotësohen sipas mod. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Njësitë vendore, kërkesat për fondet i programojnë sipas mod. 1, i dorëzojnë në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në fund të muajit qershor të vitit në vazhdim.

5. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror vlerësojnë kërkesat në përputhje me kriteret në fuqi dhe hartojnë nevojat për fondet e pagesës së PAK në nivel qarku dhe së bashku me mod. 1 për secilën bashki/komunë, brenda datës 10 korrik i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror vlerëson kërkesat e ardhura nga rajonet dhe programon fondet për projektbuxhetin e vitit pasardhës në nivel kombëtar, të cilët i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Në fund të muajit nëntor të vitit në vazhdim bashkitë/komunat, përditësojnë kërkesat për fonde sipas mod. 1 dhe i paraqesin në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Drejtoritë rajonale këto kërkesa i përcjellin brenda datës 10 dhjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

9. Shërbimi Social Shtetëror bën detajimin e fondeve të programuara për PAK sipas ligjit të buxhetit të vitit pasardhës për çdo bashki/komunë dhe i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferimin e fondeve si grante të kushtëzuara për dymujorin e parë, sipas pikës 8 të këtij udhëzimi dhe, për vazhdimësinë, transferta do të bëhet për çdo dymujor.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgon brenda datës 10 të muajit shkurt, prill, qershor, gusht dhe tetor, në Drejtorinë e Financave të MMRS-së, sektori i buxhetit, treguesit statistikorë mbi numrin e përfituesve të personave me PAK për të gjitha kategoritë dhe fondin faktik të shpenzuar të çdo dymujori, për çdo bashki/komunë, fond ky, i cili do të shërbejë për çeljen në dymujorët pasardhës, konkretisht treguesit statistikorë dhe fondi i shpenzuar, të muajve nëntor-dhjetor, do të shërbejë për çeljen e fondeve për periudhën mars-prill, e kështu në vazhdimësi për dymujorët e tjerë.

12. Udhëzimi nr. 11, datë 24.10.2012 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erjon Veliaj

QARKU _____
 BASHKIA, KOMUNA _____
 Programi i fondeve për pagesat e aftësisë së kufizuar

Moduli 1

Datë, më _____

Nr.	Emërtimi	Numri i personave PAK	Masa e pagesës	Fondi vjetor
I	Personat me aftësi të kufizuar, gjithsej (a + b + c) + kujdestar			
1	Me aftësi të kufizuara mendore, fizike, gjithsej (a + b + c)			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
d	Kujdestarë gjithsej			
	100%			
	150%			
II	Të verbër, gjithsej (a + b + c + d) + kujdestar			
2	Të verbër, gjithsej (a + b + c + d)			
a	100%			
b	150%			
c	200%			
d	300%			
	Numri i kujdestarëve			
	Kompensim energjie, i verbër me kujdestar			
	Kompensim energjie, i verbër pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për të verbër, gjithsej			
III	Para e tetraplegjik + kujdestar + paketë HS			
3	Para e tetraplegjik + gjithsej			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
d	Kujdestar gjithsej			
	100%			
	150%			
e	Paketa higjieno-sanitare			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik me kujdestar			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për para e tetraplegjik gjithsej			
IV	Nr. i invalidëve gjithsej (a + b + c + d)			
a	Sëmundje e përgjithshme, grupi I			
b	Sëmundje e përgjithshme, grupi II			
c	Sëmundje profesionale, grupi I			
d	Sëmundje profesionale, grupi II			
	TOTALI I PAK			

ADMINISTRATORI

Vula

KRYETARI

UDHËZIM
Nr. 4, datë 11.3.2014

PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE PËR
NDIHMËN EKONOMIKE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 185/2013, datë 30.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si edhe udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 3, datë 17.1.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”,

UDHËZOJ:

1. Administratori shoqëror në bashki/komunë, në përputhje me kriteret dhe treguesit, programon kërkesat për fonde për ndihmën ekonomike dhe i dërgon në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Programimi i fondeve për ndihmën ekonomike:

Programimi i fondeve mbështetet në numrin e popullsisë gjithsej, numrin e familjeve, vlerësimin e varfërisë dhe numrin e familjeve në NE, strukturën e anëtarëve të familjes (anëtarët në moshë pune, mbi moshë pune dhe nën moshë pune); personat që kanë statusin e jetimit; numrin e familjeve, që kanë fëmijë të lindur njëherësh, si: trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, viktima të trafikimit, viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare, fëmijë në familje kujdestare etj.

Në bazë të dokumentacionit, vlerësohen edhe të ardhurat që llogariten sipas koeficientëve nga pasuria, toka, blegtoria, duke përfshirë qarqet Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

3. Fondet e nevojshme për ndihmën ekonomike për bashkinë/komunën përllogariten në bazë të treguesve të mësipërm sipas mod. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Njësitë vendore, kërkesat për fondet i programojnë sipas mod. 1, dhe i dorëzojnë në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në fund të muajit qershor të vitit në vazhdim.

5. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror vlerësojnë kërkesat në përputhje me kriteret në fuqi dhe hartojnë nevojat për fondet e bllokndihmës ekonomike

në nivel qarku dhe së bashku me mod. 1 për secilën bashki/komunë, brenda datës 10 korrik i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror vlerëson kërkesat e ardhura nga rajonet dhe programon fondet për projektbuxhetin e vitit pasardhës në nivel kombëtar, të cilët i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Në fund të muajit nëntor të vitit në vazhdim bashkitë/komunat, përditësojnë kërkesat për fonde sipas mod. 1 dhe i paraqesin në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Drejtoritë rajonale këto kërkesa i përcjellin brenda datës 10 dhjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

9. Shërbimi Social Shtetëror bën detajimin e fondeve të programuara për bllokndihmën sipas ligjit të buxhetit të vitit pasardhës për çdo bashki/komunë dhe i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferimin e fondeve si grande të kushtëzuara për dymujorin e parë, sipas pikës 8 të këtij udhëzimi, dhe për vazhdimësinë transferta do të bëhet për çdo dymujor.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgon brenda datës 10 të muajit shkurt, prill, qershor, gusht dhe tetor, në Drejtorinë e Financave të MMRS-së, sektori i buxhetit, treguesit statistikorë mbi numrin e përfutuesve të personave me PAK për të gjitha kategoritë dhe fondin faktik të shpenzuar të çdo dymujori, për çdo bashki/komunë, fond ky, i cili do të shërbejë për çeljen në dymujorët pasardhës dhe konkretisht treguesit statistikorë dhe fondi i shpenzuar, të muajve nëntor-dhjetor, do të shërbejë për çeljen e fondeve për periudhën mars-prill, e kështu në vazhdimësi për dymujorët e tjerë.

12. Udhëzimi nr. 2471, datë 6.12.2012 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të proceduarave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, i ndryshuar”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erjon Veliaj

QARKU _____
 BASHKIA, KOMUNA _____
 Programimi i fondeve, për shpërndarjen e ndihmës ekonomike

Moduli 1

Datë, më _____

Nr.	Emërtimi	Struktura në numër	Masa e pagesës	Fondi mujor lekë
1	Popullsia gjithsej			
2	Familje gjithsej			
3	% e familjeve në skemë			
-	Familje në skemë, e ndarë kjo			
4	Kryefamiljarë			
5	Anëtarë mbi moshë pune			
6	Anëtarë nën moshë pune			
7	Anëtarë në moshë pune			
8	Jetim 18-25 vjeç			
9	Jetim mbi 25 vjeç			
10	3-njakë e familjeve			
11	4-njakë e familjeve			
12	5-njakë e familjeve			
13	Viktima të dhunës			
14	Viktima të trafikimit			
15	Kompensim energjie për familjet në skemë			
16	Kompensim energjie për personat me PAK			
17	Shpenzime për fëmijë deri në moshën 16 vjeç që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar (janar-qershor, shtator-dhjetor)			
18	Shpenz. mbi numrin e të vaksinuarve sipas një kalendari për çdo fëmijë në familjet përfituese në nëntor			
19	Fëmijë normal në familje kujdestare			
20	Fëmijë me AK në familje kujdestare			
a.	Shpenz. indirekt + shkollë për fëmijë normal në familje kujdestare në shtator			
b.	Shpenz. indirekt + shkollë për fëmijë AK në familje kujdestare në shtator			
A	Fondi sipas strukturës dhe individëve për 1 muaj (4 deri 20)			
B	Të ardhurat gjithsej, mujore			
-	Të ardhurat nga toka			
-	Të ardhurat nga blegtoaria			
-	Të ardhurat nga pensionet			
-	Të ardhurat të tjera			
C	Fondi vjetor ((A-B) X 12 muaj)			
Ç	Fondi për (a+b) x 1 muaj			
D	Fondi gjithsej (c+ç)			

ADMINISTRATORI

Vula

KRYETARI

UDHËZIM

Nr. 217, datë 28.3.2014

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMORE QË MIRATOHEN NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË TERRITORIT, SI DHE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.9.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 "Për miratimin e

rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore, që miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT), nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), si dhe ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e tyre.

2. Shqyrtimi i kërkesës së subjektit, që paraqitet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, mbi aplikimin për marrje leje zhvillimore që miratohet në KKT për struktura apo punime brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MZHETS-ja, bëhet nga Komisioni Teknik në MZHETS.

3. Komisioni Teknik merr në shqyrtim kërkesën, vetëm pasi ka verifikuar se subjekti ka kryer pagesën për “tarifën e aplikimit” (e përcaktuar në përmbushje të kërkesës së germës “C”, seksioni 8 i formularit TIP 1 “Kërkesë për kryerje punimesh”, shtojca 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, “Fatura e pagesës për tarifën e aplikimit”).

4. Vlera e tarifës së aplikimit është 10.000 (dhjetë mijë) lekë, pavarësisht nga lloji i strukturës për të cilën kërkohet leja e zhvillimit, e cila paguhet për llogari të MZHETS-së.

5. Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore, që miratohen në KKT, dhe përdorimi për struktura apo punime brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MZHETS-ja, ngrihet “Komisioni Teknik”, me përbërje si më poshtë:

- Sekretar i Përgjithshëm	kryetar;
- Drejtor i Koordinimi dhe Jetësimit të Prioriteteve Pol. Ekonomike	anëtar;
- Drejtor i Tregut të Brendshëm	anëtar;
- Drejtor i Mbështetjes së Sipërmarrjes	anëtar;
- Drejtor i Privatizimit	anëtar;
- Drejtor i Shërbimeve Juridike	anëtar;
- Përgjegjës Sektori i Menaxhimit të Shoq. Shtetërore	anëtar.

Komisioni Teknik asistohet nga Sekretariati Teknik, që përbëhet nga Drejtoria e Koordinimit Strategjik dhe Konvergimit Rajonal të Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Konkurrueshmërisë dhe Partneritetit dhe Drejtoria e Privatizimit.

6. Përcaktimi i emrave në përbërje të “Komisionit Teknik” për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore në MZHETS dhe “Sekretariatit Teknik”, bëhet nëpërmjet urdhrat të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

7. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje zhvillimore, që miratohen në KKT, mblidhet me kërkesë të kryetarit, sa herë që kërkohet shqyrtimi i praktikave për leje, sipas objektit të fushës së veprimtarisë së MZHETS-së, që kanë impakt ekonomik, fushë të gjerë dhe interes publik, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. Në njoftimin e dhënë nga kryetari, jepet edhe agjenda e mbledhjes së Komisionit, si dhe vendi, data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

9. Mbledhja e Komisionit zhvillohet vetëm në rast se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Përgjithësisht, në pamundësi të pranishëm të shumicës së anëtarëve, si më sipër, dhe vetëm për shqyrtimin e kërkesave për çështje të formës, mbledhja mund të kryhet me praninë e jo më pak se 3 anëtarëve të Komisionit së bashku me kryetarin.

10. Kryetari i Komisionit cakton një person në rolin e sekretarit të këtij Komisioni.

11. Kërkesa për leje zhvillimore komplekse, i dërgohet menjëherë për shqyrtim Komisionit Teknik. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës, Komisioni Teknik kryen shqyrtimin e kërkesës për çështje të formës.

12. Kërkesa për leje që miratohet në KKT, sipas objektit të fushës së veprimtarisë së MZHETS-së, duhet të përmbajë, sipas rastit:

a) Kërkesën për kryerje punimesh të plotësuar, në çdo pjesë të zbatueshme të saj, nga kërkuesi i lejes së zhvillimit, sipas formularit TIP 1 të shtojcës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011, i ndryshuar;

b) Vërtetim nga QKR-ja për subjektin kërkues të lejes dhe zbatuesin e punimeve, edhe për sa i përket faktit që nuk janë në gjendje likuidimi apo falimentimi;

c) Dokumentin që vërteton pronësinë mbi tokën që do të zhvillohet, sipas standardeve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (certifikatë për vërtetimin e pronësisë, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese e regjistrimit) dhe vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në lidhje me barra a kufizime të mundshme mbi pasurinë e paluajtshme, ku propozohet të zhvillohet;

ç) Prokura nëpërmjet së cilës pronari apo pronarët, sipas rastit, autorizojnë kërkuesin e lejes zhvillimore komplekse, në rast se leja nuk kërkohet nga pronarët;

d) Akti noterial i lidhur, midis zhvilluesit dhe shoqërisë/shoqërive zbatuese, si dhe licencat për punime zbatimi. Licenca e shoqërisë zbatuese, shoqërohet edhe me vërtetim nga gjykata, prokuroria, përbarimi dhe inspektorati ndërtimor;

dh) Pozicionin e zhvillimit në kuadër të planeve të miratuara për zonën përkatëse;

e) Plani i vendosjes së strukturës/strukturave, ku paraqiten kufijtë e pronave, gjurmët e rrugëve ekzistuese dhe ato të propozuara nga planet, distancat, tabela me llogaritjet e mënyrës së zbatimit të intensitetit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për ndërtesa, rrugë dhe hapësirë publike. Ky plan shoqërohet edhe me rievimin topogjeodezik, të firmosur nga organi ose individi me licencë gjeodezike;

ë) Projekti i plotë arkitektonik për të gjitha nivelet e strukturës. Ky projekt përmban edhe relacionin shpjegues, ku përshkruhen edhe rifiniturat, sipas rastit;

f) Plani i lidhjes së strukturës me infrastrukturën në zonë. Në këtë plan paraqiten edhe të gjitha infrastrukturën ekzistuese në zonë;

g) Projekti i sistemimeve të jashtme, me firmën origjinale të projektuesve, me kuota altimetrike, paraqitje e zonave të gjelbra, si edhe numri dhe lloji i drurëve që do të mbillen, dhe projekti i sistemimit të ujerave të shiut dhe lidhja e tij me rrjetin kryesor;

gj) Studimet gjeologo-inxhinierike për ndërtimet me ose mbi 5 kate dhe të dhënat gjeologjike për ndërtimet nën 5 kate, hidrogeologjike dhe harta sizmologjike. Studimi mikrosizmik inxhiniero-sizmologjik, kërkohet për ndërtimet me ose mbi 8 kate;

h) Plani i organizimit të punës dhe grafiku i punimeve dhe i mbikëqyrjes së punimeve me firmën origjinale të projektuesve. Në planin e organizimit të punimeve përcaktohen qartë edhe rrethimi i sipërfaqes së sheshit të kryerjes së punimeve, vendet e depozitimit të materialeve, vendi i tabelës informuese të ndërtimit, pozicioni i vinçit, depozitat e ujit për përdorim ndërtimi, skema e qarkullimit të mjeteve të transportit dhe mbrojtja e sigurimit teknik gjatë ndërtimit, në shkallën 1:500 dhe 1:200;

i) Projekti teknik i zbatimit dhe preventivi i realizimit të punimeve. Projekti teknik i zbatimit, dorëzohet me firmë origjinale nga projektuesit, shoqërohet me tabelën e fletëve për secilin nga projektet përbërëse, si më poshtë dhe përmban:

a) projektin konstruktiv dhe planin e piketimit të strukturave;

b) projektin e plotë të ngrohjes dhe të ventilimit;

c) projektin elektrik dhe projektin për instalimet hidrosanitare;

d) parashikimin për vendosjen e kutisë postare;

e) paraqitjen e elementeve të projektit arkitektonik, që lehtësojnë aksesin apo eliminojnë pengesat për përdorimin e strukturës nga personat me aftësi të kufizuara;

f) tipat e ndarjeve funksionale të strukturës, sipas rastit, sipërfaqet për secilin tip dhe në total sasia e njëjësive të ndarjeve funksionale, planimetritë për secilin tip;

g) Projekti i mbrojtjes kundër zjarrit;

k) Vërtetimi i kryerjes së pagesës për taksat dhe tarifatat vendore për ndërtimin dhe/ose zhvillimin e tokës;

l) Vërtetimi dhe/ose certifikatat e kryerjes së të gjitha pagesave mbi detyrimet e kërkuesit të lejes zhvillimore;

m) Sipas rastit, dokumentin e miratuar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

n) Fotokopje e noterizuar e licencave të projektuesve, si: arkitekti, konstruktori, inxhinierët elektrikë, hidro etj., të vlefshme brenda afatit të projektimit dhe të ndërtimit të strukturës;

nj) Sipas rastit dhe llojit të zonës ku do të kryhen punimet, vërtetime, leje ose dokumente të tjera që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për sektorë apo punime të veçanta.

13. Në rast se dokumentacioni i kërkesës nuk është i plotë, subjekti njoftohet duke i lënë një afat 30-ditor për plotësimin e mangësive.

14. Në rast se dokumentacioni i kërkesës është i plotë, MZHETS-ja boton menjëherë kërkesën për leje në

Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe bashkërendon punën me bashkinë/komunën ku propozohet të kryhet zhvillimi, Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore dhe/apo operatorët e shërbimeve publike, sipas nenit 70/16 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, për t'u siguruar se kërkesa është në përputhje me zhvillimin e lejuar në zonën përkatëse.

15. Komisioni bën afishimin në portalin e MZHETS-së, të njoftimit për kërkesën për leje zhvillimore që miratohet në KKT.

16. Mbledhja e Komisionit Teknik për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore që miratohet në KKT, sipas objektit të veprimtarisë së MZHETS-së, bëhet jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e dosjes me të gjitha materialet dhe dokumentacionin përkatës, që lidhen dhe janë në plotësim të kërkesës së paraqitur nga subjekti për marrjen e lejes, përfshirë edhe opinionet e institucioneve të tjera shtetërore ose, kur vlerësohet e nevojshme, nga ekspertë të fushës. Komisioni shqyrton kërkesën dhe merr vendimin, brenda 10 ditë pune.

17. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave në MZHETS, bën trajtimin e çështjeve, si më poshtë:

- shqyrton kërkesat për dhënie leje zhvillimore, që miratohet në KKT brenda fushës së veprimtarisë shtetërore, që mbulon MZHETS-ja, duke kryer:

a) kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja teknike dhe ligjore të dokumentacionit që shoqëron aplikimin;

- mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e Komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë edhe opinionin nga institucionet e tjera ose ekspertë të fushës, Komisioni merr vendimin për:

i) pranim të kërkesës;

ii) refuzim të kërkesës, duke paraqitur te ministri informacionin me argumentet përkatëse, për shkaqet e refuzimit.

18. Komisioni merr vendim me shumicë votash.

Për çdo kërkesë që shqyrtohet, Komisioni harton procesverbalin përkatës, i cili duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Në rast refuzimi të kërkesës, MZHETS-ja njofton subjektin aplikues, duke dhënë edhe argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit. Subjekti aplikues ka të drejtën të aplikojë përsëri, pasi të ketë plotësuar mangësitë e evidentuara.

19. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankimi te ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

20. Sekretariati i Komisionit Teknik përgatit shkresën, e cila përcillet në AKPT për procedim të mëtejshëm, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), e cila përfshin:

- propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

- për shqyrtimin e kërkesës për leje;
- një kopje të vendimit të Komisionit Teknik në lidhje me kërkesën për leje;
- dokumentacionin e plotë shoqërues të kërkesës për leje.

21. Pas dërgimit në MZHETS të vendimit të KKT-së për miratimin e lejes së zhvillimit, Sekretariati Teknik përgatit dokumentin administrativ teknik për zbardhjen e lejes, sipas formularit përkatës të vendimit nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

22. Dokumenti administrativ teknik firmoset nga ministri në dy kopje origjinale.

23. Sekretariati i Komisionit Teknik, nëpërmjet zyrës së protokollit të MZHETS-së, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij, një kopje origjinale të firmosur të dokumentit administrativ teknik, që i referohet vendimit të KKT-së për miratimin e lejes, jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së vendimit nga KKT-ja.

24. Leja e përdorimit, në përfundim të punimeve, jepet nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes pas vlerësimit nga Komisioni Teknik të dokumentacionit të depozituar, si vijon: procesverbalit dhe aktit të kolaudimit, relacionit të mbikëqyrësit të punimeve, aktet e kontrollit, të përpiluara nga specialistët e Komisionit Teknik, aktet e kolaudimit dhe/ose procesverbalet nga institucionet e rrjeteve të infrastrukturës.

25. Leja e përdorimit botohet në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

26. Në rast refuzimi të lejes së përdorimit, në zbatim të pikës 4 të nenit 79 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, lëshohet akti i konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili në pjesën e arsyetimit u referohet dokumenteve të akteve të kontrollit.

27. Sekretariati i Komisionit Teknik, nëpërmjet zyrës së protokollit në MZHETS, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij, një kopje origjinale të dokumentit të lejes së përdorimit, të firmosur nga ministri.

28. Dosja e plotë e dokumentacionit të kërkesës për leje zhvillimi, së bashku me opinionet teknike, lejet përkatëse të zhvillimit dhe të përdorimit, depozitohen në arkivin e MZHETS-së.

29. Për ndjekjen e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i MZHETS-së, Komisioni dhe Sekretariati Teknik.

30. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj

KËRKESË

Nr. 887/2, datë 19.3.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtmshme të tipit “tokë bujqësore arë” që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv, Ersekë-Përmet”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “OST” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të kryhet për një periudhë 1-javore. Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË
Damian Gjijnuri

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 KV ERSEKË - PËRMET

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë, truall, pyll, kullotë

Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia											
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime	
Qarku Korçë													
ERSEKË		1594											
1	1	Sotir		Prifti	arë	1594	25/40	4400	25.54	135	3448.29		
2	2	Shefqet		Dodo	arë	1594	259/44	3556	47.83	135	6457.19		
3	3	Pretendim pronësie			arë	1594	259/67	44447	15.16	135	2045.99		
4	4	Pretendim pronësie			arë	1594	259/67/1	7276	15.16	135	2045.99		
									∑ =	103.68	∑ =	13997.46	
Qarku Korçë													
KOMUNA QENDËR													
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia											
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime	
TAC Qendër		3558											
1	6	Fatmir	Avdulla	Mydini	arë	3558	315/21	4025	15.16	135	2045.99		
2	7	Petrit	Hysni	Lifo	arë	3558	318/5	1317	23.17	135	3128.57		
3	9	Ferit	Hasan	Mydini	arë	3558	540/13	5450	15.16	135	2045.99		
									∑ =	53.49	∑ =	7220.54	
TAC I POSHTËM		3556											
1	10	Pretendim pronësie			arë	3556	574/9	90859	16.59	142	2355.68		
									∑ =	16.59	∑ =	2355.68	
BOROVË		1251											
1	13	Kita	Kostandin	Mediu	arë	1251	337/1	2526	16.59	135	2239.56		
2	14	Robert	Themistokli	Qoku	arë	1251	340/1	2704	15.16	135	2045.99		
3	15	Kristo	Ziko	Gega	arë	1251	355/2	11882	23.17	135	3128.57		
4	17	Nikola	Ziko	Gorica	arë	1251	369/2	5000	15.16	135	2045.99		
									∑ =	70.07	∑ =	9460.10	
Qarku Korçë													
KOMUNA BARMASH													
Nr	Numri i shtyllës	Pronësia											
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime	
BARMASH		1119											
1	30	Spiro	Illi	Karai	arë	1119	46	3315	50.87	135	6867.41		
2	31	Xhelo	Nexhip	Duro	arë	1119	186	2475	15.16	135	2045.99		
3	32	Spiro	Aristotel	Dhembi	arë	1119	554	2443	21.28	135	2872.77		
4	33	Arben	Jorgji	Risto	arë	1119	728	2724	23.17	135	3128.57		
5	34	Viktor	Mitre	Lilo	arë	1119	869	5076	15.16	135	2045.99		
6	35	Sotir	Illi	Lilo	arë	1119	948	11013	15.16	135	2045.99		
									∑ =	140.79	∑ =	19006.71	

SHALËS		3117										
1	46	Sotir	Ligor	Misha	arë	3117	60	22204	16.59	135	2239.56	
2	47	Petro	Sotir	Ile	arë	3117	149	10960	16.59	135	2239.56	
3	48	Pretendim pronësie			arë	arë	195	8097	15.16	135	2045.99	
4	49	Koco	Ligor	Bello	arë	3117	259	8840	16.59	135	2239.56	
									Σ =	64.92	Σ =	8764.66

Qarku Korçë		KOMUNA LESKOVIK										
Nr	Numri i shtyllës	Pronësia										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	
RADANJË		3134										
1	59	Nexhip	Vehap	Lilo	arë	3134	112	855	47.83	135	6457.19	
									Σ =	47.83	Σ =	6457.19
VREPCKË		arë										
1	63	Pretendim pronësie			ledh	arë	54	8426	19.65	105	2063.41	
2	64	Pretendim pronësie			arë	3826	42	45756	18.09	142	2568.50	
									Σ =	37.74	Σ =	4631.90
LESKOVIK		2430										
1	83	Pretendim pronësie			Kullotë	2430	379/3		19.65	87	1709.68	
2	92	Pretendim pronësie				2430	920/2		47.83	135	6457.19	
3	93	Pretendim pronësie				2430	902/5		16.59	135	2239.56	
									Σ =	84.07	Σ =	10406.43

Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	
Qarku Gjirokastrë		KOMUNA ÇARÇOVË										
ÇARÇOVË		1356										
1	113	Bashkëpronësi			arë	1356	108		19.65	135	2652.95	
2	119	Trifon	Peci	Cicollli	arë	1356	22/1	2272	23.17	135	3128.57	
3	120	Bashkëpronësi			arë	1356	19/27	1330	15.16	135	2045.99	
									Σ =	57.98	Σ =	7827.51

ZHEPË		3927										
1	121	Petrit	Hasan	Ahmeti	arë	3927	711	3415	15.16	135	2045.99	
2	122	Pretendim pronësie			arë	3927	689	10042	15.16	135	2045.99	
3	123	Pretendim pronësie			arë	3927	178	22837	15.16	135	2045.99	
4	124	Pretendim pronësie			arë	3927	179	25689	15.16	135	2045.99	
5	125	Sotir	Koco	Nika	arë	3927	158	4048	15.16	135	2045.99	
6	126	Mitre	Kici	Proko	arë	3927	89	1121	15.16	135	2045.99	
7	127	Dhimiter	Thanas	Deraso	arë	3927	44	4246	25.54	135	3448.29	
									Σ =	116.48	Σ =	15724.21

Fletore Zyrtare nr.41, datë 1 prill 2014

DRAÇOVË		1523									
1	130	Josif	Ilia	Shukollari	arë	1523	466	3580	47.83	135	6457.19
2	131	Sofokli	Aleks	Keruti	arë	1523	310	3860	85.24	135	11506.77
3	132	Sotir	Themistokli	Shukollari	arë	1523	254	1327	23.17	135	3128.57
4	133	Sotir	Vasil	Nasi	arë	1523	110	5575	18.09	135	2441.88
5	134	Spiro	Kici	Tetollari	arë	1523	71	943	18.09	135	2441.88
								Σ =	192.42	Σ =	25976.30

Qarku Gjirokastrë KOMUNA ÇARÇOVË		Pronësia										
Nr.	Numri i shtyllës	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
KANIKOL		2073										
1	135	Gogo	Ndreko	Petro	arë	2073	139	4976	16.59	135	2239.56	
2	136	Janaq	Spiro	Stefani	arë	2073	88	3687	47.83	135	6457.19	
								Σ =	64.42	Σ =	8696.75	

ILJARË		1981									
1	137	Bashkëpronësi			Arë		771	1376	15.16	135	2045.99
2	137				Arë	1981	770	652		135	
								Σ =	15.16	Σ =	2045.99

PËLLUMBAR		2899									
1	138	Bashkëpronësi			arë	2899	280	11800	15.16	135	2045.99
2	139	Stavro	Vangjel	Papa	arë	2899	196	8171	47.83	135	6457.19
3	140	Lonidha	Dhimiter	Peci	arë	2899	140	5773	57.04	135	7700.03
								Σ =	120.02	Σ =	16203.20

STRËMBEC		3524									
1	143	Thanas	Stefan	Qirollari	arë	3524	1030	2715	39.59	135	5345.06
2	144	Pano	Miti	Qirollari	arë	3524	1016	2691	15.16	135	2045.99
3	145	Ferdinand	Janaq	Ristani	arë	3524	908	2762	15.16	135	2045.99
4	146	Sotir	Llazo	Qirollari	arë	3524	621	1666	15.16	135	2045.99
5	147	Isuf	Teki	Nuredini	arë	3524	459	2271	23.17	135	3128.57
6	149	Jorgji	Mihal	Pecollari	arë	3524	193	2238	18.09	135	2441.88
								Σ =	126.32	Σ =	17053.47

Qarku Gjirokastrë KOMUNA PETRAN		Pronësia										
Nr	Numri i shtyllës	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
KALUDH		2057										
1	151	Pretendim pronësie			arë	2057	510	4038	56.49	135	7626.18	
2	152	Jano	Josif	Thanasi	arë	2057	452	400	47.83	135	6457.19	
3	153	Ligor	Pandeli	Sotiri	arë	2057	424	484	18.09	135	2441.88	
4	154	Bashkëpronësi			arë	2057	297		21.28	135	2872.77	
5	155	Kolo	Koco	Proko	arë	2057	221	8310	19.65	135	2652.95	
6	156	Thanas	Koco	Sotiri	arë	2057	140	1272	18.09	135	2441.88	
								Σ =	181.43	Σ =	24492.86	

PETRAN		2946									
1	160	Vladimir	Argjir	Simoni	Arë	2946	159/11	4508	47.83	179	8561.76
	160	Sheme	Ismail	Lulo	Arë	2946	159/12				
2	161	Stavro	Nastas	Proko	Arë	2946	159/7	8753	15.16	179	2712.83
3	162	Josif	Kolo	Mitre	Arë	2946	159/3	5901	15.16	179	2712.83
4	163	Pretendent pronësie			Arë	2946	154/2	2500	25.54	179	4572.18
5	164	Pretendent pronësie			Kullotë	2946	149	5400	75.97	114	8660.43
6	165	Pretendent pronësie			Arë	2946	140		86.79	179	15535.03
7	166		Bashkëpronësi		Arë	2946	144		47.83	179	8561.76
8	167		Bashkëpronësi		Arë	2946	73	29500	15.16	179	2712.83
9	168		Bashkëpronësi		Arë	2946	142/1	5800	15.16	179	2712.83
10	169	Asan	Refat	Goxhaj	Arë	2946	124/2	606	18.09	179	3237.75
11	170	Xhelo	Muharrem	Halimi	Arë	2946	116/4	522	47.83	179	8561.76
								Σ =	410.50	Σ =	68541.97

Qarku Gjirokastrë		KOMUNA PETRAN										
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
BADELONJË		1071										
1	172	Pretendent pronësie			Arë	1071	87/5	8062	15.16	135	2045.99	
	172	Pretendent pronësie			Arë	1071	91	1843		135		
	173	Koco	Petro	Poci	Arë	1071	84/2	2332	16.59	135	2239.56	
2	174	Dylber	Xhemal	Tare	Arë	1071	17/5	6413	23.17	135	3128.57	
4	175	Shezai	Abedin	Ferati	Arë	1071	15/34	3058	85.24	135	11506.77	
5	176	Pretendent pronësie			Arë	1071	209/16	5250	34.48	135	4655.33	
6	177		Bashkëpronësi		Arë	1071	208		18.09	135	2441.88	
								Σ =	192.73	Σ =	26018.10	
QILARISHT		3115										
1	182	Kici	Mina	Tatazi	Arë	3115	377/112	3080	65.87	179	11790.63	
2	183	Petraç	Kici	Tatazi	Arë	3115	256/13	2900	16.59	179	2969.49	
3	184	Margarita	Sotir	Nasi	Arë	3115	257/14	2845	15.16	179	2712.83	
4	185	Pretendent pronësie			Arë	3115	285/4		47.83	179	8561.76	
								Σ =	145.45	Σ =	26034.71	
		3967										
1	186	Pretendent pronësie			Arë	3967	160/10		15.16	179	2712.83	
2	187	Pretendent pronësie			Arë	3967	137/19		18.09	179	3237.75	
3	188	Pretendent pronësie			Arë	3967	133/9		39.59	179	7087.15	
4	191	Pretendent pronësie			Arë	3967	150/8		47.83	179	8561.76	
5	192	Pretendent pronësie			Arë				76.98	179	13779.97	
								Σ =	197.65	Σ =	35379.46	

Tabela përmbledhëse

Nr.	Objekti	Sip shpronësimi	Shuma totale në lekë
1	Linja 110kV Ersekë - Përmet	2439.74	356295.20

KËRKESË
Nr. 1492, datë 17.3.2014
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim rrugët paralele superstrada Tiranë-Vorë, krahu i majtë (vazhdimi)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken na ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 2 313 920 (dy milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**
Edmond Haxhinasto

Lista e Pronave qe Shpronsohen nga ndertimi i segmentit rrugor
"Ndertim rrugjet paralele superstrada Tirane Vore (krahu i majte)"

Nr. Rendor	PRONARI			Z.Kadastrale	Nr.Pasurise	lloji i pasurise	siperfaqja totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lek/m2)	Vlera (Lekte)	VLERA TOTALE (Lekte)	SHENIME
	Emer	Atesi	Mbiemer									
1	"ALB-STAR" SH.P.K			2679	1/25	Are	3900	531	448	237,888	237,888	Blokim Hipotekor ne favor te INTESA SANPAOLO BANK
2	Fuat	Shaban	Murati	2679	1/96	Are	4550	684	448	306,432	306,432	Konfirmohet nga ZVRPP
3	Fatos	Shygyri	Fucia	2679	1/11/32	Are	2000	70	448	31,360	31,360	Konfirmohet nga ZVRPP
4	Shygyri	Ramazan	Fucia	2679	1/79	Are	3140	392	448	175,616	175,616	Konfirmohet nga ZVRPP
5	Kujtim	Rushit	Fucia	2679	1/91	Are	820	198	448	88,704	88,704	Konfirmohet nga ZVRPP
6	I Paidentifikuar			2679	1/...	Are	-	4	448	1,792	1,792	I Pakonfirmuar
7	Kujtim	Rushit	Fucia	2679	1/84	Are	322	30	448	13,440	13,440	Konfirmohet nga ZVRPP
8	Kujtim	Rushit	Fucia	2679	1/85	Are	1053	158	448	70,784	70,784	Konfirmohet nga ZVRPP
9	Gani	Reshit	Fucia	2679	1/19	Are	1800	193	448	86,464	86,464	Konfirmohet nga ZVRPP
10	Reshit	Osman	Fucia	2679	1/56	Are	3070	269	448	120,512	120,512	Konfirmohet nga ZVRPP
11	Adil	Qamil	Gjini	2679	1/55	Are	800	42	448	18,816	18,816	Konfirmohet nga ZVRPP
12	Beqir	Reshit	Fucia	2679	1/59	Are	340	208	448	93,184	93,184	Konfirmohet nga ZVRPP
13	Ramazan	Maksut	Peza	2679	1/11/34	Are	2500	342	448	153,216	153,216	Konfirmohet nga ZVRPP
14	Islam	Maksut	Peza	2679	1/11/33	Are	2500	485	448	217,280	217,280	Konfirmohet nga ZVRPP
15	Ylli	Besim	Lleshi	2679	1/97	Are	1943	1559	448	698,432	698,432	Konfirmohet nga ZVRPP
Totali								5165		2,313,920	2,313,920	

Vendim
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 247, datë 12.3.2014, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Gëzim Hajdari, i biri i Hysenit dhe i Selvisë, i datëlindjes 6.11.1975, që nga data 25.10.1996; si dhe caktimin në cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij, motrën e tij, shtetasen Valbona Hajdari.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 20 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006